



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05
Prokurori kundër Salih Mustafës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 25 mars 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendimi i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit
Julius von Bone

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 41 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 shtator 2020, Salih Mustafa (“z. Mustafa”) u arrestua në bazë të vendimit² dhe të fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake (“Fletarrestimi”),³ në vijim të konfirmimit të aktakuzës kundër tij.⁴

2. Përkatësisht, më 23 nëntor 2020 dhe 25 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori vendimin e parë dhe të dytë mbi rishikimin e paraburgimit të z. Mustafa, duke urdhëruar vazhdimin e paraburgimit të tij (“Vendimi i Parë i Rishikimin” dhe “Vendimi i Dytë i Rishikimit”).⁵

3. Më 5 mars 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kërkoi nga palët që të dorëzonin parashtrime me shkrim nëse ekzistonin ende arsye për vazhdimin e paraburgimit të z. Mustafa.⁶

¹ KSC-BC-2020-05, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-05, F00009, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Urdhrit për Transferim* (“Vendimi për Arrestim dhe Transferim”), 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2020-05, F00009/A01/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Fletarrestimit për z. Salih Mustafa* (“Fletarrestimi”), 12 qershor 2020, publik.

⁴ KSC-BC-2020-05, F00008/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit për Konfirmimin e Aktakuzës kundër Salih Mustafës* (“Vendimi i Konfirmimit”), 5 tetor 2020, publik, para. 37.

⁵ KSC-BC-2020-05, F00052, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Rishikimin e Paraburgimit* (“Vendimi i Parë i Rishikimit”), 23 nëntor 2020, publik; F00068, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit* (“Vendimi i Dytë i Rishikimit”), 25 janar 2021, publik.

⁶ KSC-BC-2020-05, Transkripti, 5 mars 2021, publik, f. 203, rreshtat 12-13.

4. Më 11 mars 2021, Mbrojtja dorëzoi parashtrimet e saj.⁷

5. Më 17 mars 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi parashtrimet e veta.⁸

II. PARASHTRIMET

6. Mbrojtja parashtron se z. Mustafa duhet të lirohet, ose të lirohet me kusht.⁹ Në veçanti, Mbrojtja parashtron se: (i) pas gjashtë muajsh në paraburgim është i përligjur rishikimi i dyshimit të bazuar mirë;¹⁰ (ii) rreziqet e konstatuara në lidhje me të akuzuarin janë thjesht teorike;¹¹ dhe (iii) duhen marrë parasysh rrethanat personale të të akuzuarit, duke përfshirë mundësinë e humbjes së punës dhe rrjedhimisht të ardhurat për familjen e tij.¹² Nëse do të lirohet me kusht, z. Mustafa pranon t'i përmbahet çdo kushti që gjykohet i përshtatshëm nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, duke përfshirë: dorëzimin e pasaportës së vet te autoritetet kompetente; të kërkojë leje për çdo udhëtim të lidhur me punën; arrestin shtëpiak, të paraqitet para një punonjësi të sigurisë së ZPS-së, të paraqitet para Dhomave të Specializuara ("DHS") nëse urdhërohet, të ketë pajisje teknike monitorimi të instaluara në shtëpi ose në trupin e tij, dhe, nëse është e nevojshme, t'i hiqet e drejta për të udhëtuar ose punuar. ("Kushtet e Propozuara").¹³

7. ZPS-ja parashtron se rrethanat që Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka konstatuar më parë nuk kanë ndryshuar dhe, si pasojë, mbajtja në paraburgim e z. Mustafa

⁷ KSC-BC-2020-05, F00095, Mbrojtja, *Parashtrime të Mbrojtjes për Rishikimin e Paraburgimit të të Akuzuarit* ("Parashtrimet e Mbrojtjes"), 11 mars 2021, publik.

⁸ KSC-BC-2020-05, F00096, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë mbi Rishikimin e Paraburgimit* ("Parashtrimet e ZPS-së"), 17 mars 2021, publik.

⁹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 52.

¹⁰ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 7.

¹¹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 13-14, 18, 21.

¹² Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 40-49.

¹³ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 23-24, 35-36.

vazhdon të jetë e nevojshme.¹⁴ Në veçanti, ZPS-ja argumenton se Mbrojtja nuk dha arsye përse dyshimi i bazuar mirë se z. Mustafa është penalisht përgjegjës për krimet e paraqitura në akuza nuk ekziston më.¹⁵ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se Mbrojtja nuk paraqiti argumente të reja përse rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit nuk ekzistojnë më.¹⁶ Sa u përket kushteve të propozuara nga Mbrojtja, ZPS-ja argumenton se asnjë kusht nuk do të zbuste mjaftueshëm rreziqet e konstatuara tashmë, dhe se në këtë aspekt paraburgimi është mjeti i vetëm efektiv.¹⁷ Së fundi, ZPS-ja parashtron se rrethanat personale dhe profesionale të të akuzuarit nuk duhet të konsiderohen si faktorë lehtësues të rreziqeve, dhe se kthimi i të akuzuarit në punën e tij në fakt mund të rrisë rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit.¹⁸

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Neni 41(6) i Ligjit parasheh se DHS-ja urdhëron arrestimin dhe paraburgimin e një personi vetëm kur ekziston dyshim i bazuar mirë se personi ka kryer veprë penale brenda juridiksionit të DHS-së dhe ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se: (i) personi përbën rrezik për arratisje; (ii) personi do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë prova të veprës penale, apo rrethana konkrete tregojnë se ai ose ajo do të pengojnë ecurinë e procedurës penale; ose (iii) natyra e rëndë e veprës penale, ose mënyra apo rrethanat në të cilën është kryer dhe karakteristikat personale të tij ose të saj, sjellja në të shkuarën, mjedisi dhe kushtet në të cilat jeton ai ose ajo apo rrethanat e tjera personale tregojnë rrezikun që personi ta përsërisë veprën penale, të të

¹⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 2-3.

¹⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 5.

¹⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 11, 13, 15.

¹⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 17.

¹⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 19.

përfundojë një vepër penale në tentativë ose të kryejë një vepër penale që personi ka tentuar ta kryejë.

9. Neni 41(10) i Ligjit parasheh se, deri në momentin që aktgjykimi merr formë të prerë ose deri në lirimin nga paraburgimi, me kalimin e dy (2) muajve pas vendimit të fundit për mbajtje në paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose Trupi Gjykues i ngarkuar me çështjen shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim dhe nxjerr vendimin për vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit. Në bazë të rregullës 57(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e rishikon vendimin për mbajtjen në paraburgim pas kalimit të dy (2) muajve nga vendimi i fundit për paraburgimin.

10. Neni 41(12) i Ligjit përcakton se, krahas mbajtjes në paraburgim, mund të urdhërohen masat në vijim për të siguruar praninë e të akuzuarit, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale apo për të siguruar kryerjen me sukses të procesit penal: fletëthirrja, arrestimi, dorëzania, arresti shtëpiak, premtimi për të mos u larguar nga vendbanimi, ndalimi për t'iu afruar vendeve ose personave të caktuar, paraqitja në një stacion policor apo vend tjetër, dhe masa alternative shmangëse.

IV. DISKUTIM

11. Në bazë të nenit 41(10) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka detyrimin të shqyrtojë nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim, përfshirë arsyet e përcaktuara në nenin 41(6) të Ligjit, konkretisht nëse (i) ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer veprën ose veprat penale; dhe (ii) ka arsye të artikulueshme për të besuar se përmbushet ndonjë nga kriteret e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.

A. DYSHIMI I BAZUAR

12. Sa i përket standardit për vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(a) i Ligjit kërkon ekzistencën e dyshimit të bazuar se është kryer një vepër penale që përfshihet në juridiksionin e DHS-së.¹⁹ Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton konstatimin e tij se për arsye se aktakuza kundër z. Mustafa është konfirmuar,²⁰ kriteri i nenit 41(6)(a) të Ligjit është përmbushur.²¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake përsërit se procesi i vlerësimit të provave në mbështetje të akuzave do të ndodhë gjatë fazës së gjyqimit kur do të përcaktohet fajësia apo pafajësia e z. Mustafa.²² Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se Mbrojtja nuk ngre ndonjë argument konkret në mbështetje të pretendimit të saj se dyshimi i bazuar kundër të akuzuarit nuk ekziston më. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se në procesin aktual gjatë kësaj kohe nuk ka pasur ndonjë informacion apo zhvillim të ri që do të justifikonte rivlerësimin e konstatimeve të mësipërme.

13. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se përmbushet standardi i nenit 41(6)(a) të Ligjit.

¹⁹ Sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të vitit 2012, Ligji nr. 04/L-123, standardi që provon ekzistencën e “dyshimit të bazuar” përcaktohet si “njohuri për informacionin që do të bindte një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur, po ndodh ose ka mundësi të konsiderueshme që do të ndodhë dhe se personi në fjalë ka më shumë gjasa që të ketë kryer veprën penale se sa që të mos e ketë kryer atë”. Vendimi i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit, para. 14. *Shih gjithashtu* neni 5(1)(c) i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, sipas interpretimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, *Fox, Campbell and Hartley v. United Kingdom*, no. 12244/86; 12245/86; 12383/86, [Judgment](#), 30 August 1990, para. 32; *K.-F. v. Germany*, no. 144/1996/765/962, [Judgment](#), 27 November 1997, para. 57; *Labita v. Italy*, no. 26772/95, [Judgment](#), 6 April 2000, para. 155; *Berkday v. Turkey*, no. 22493/93, [Judgment](#), 1 March 2001, para. 199; *O’Hara v. United Kingdom*, no. 37555/97, [Judgment](#), 16 October 2001, para. 34.

²⁰ Vendimi i Konfirmimit, para. 163(a).

²¹ Fletarrestimi, para. 1; Vendimi për Arrestim dhe Transferim, para. 18.

²² Vendimi i Dytë i Rishikimit, para. 14.

B. DOMOSDOSHMERIA E PARABURGIMIT

14. Pas përmbushjes së standardit të nenit 41(6)(a) të Ligjit, arsyet që e lejojnë Gjykatësin e Procedurës Paraprake t'i heqë lirinë një personi duhet të jenë të artikulueshme.²³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit, Paneli duhet të bazohet në arsye të artikulueshme – d.m.th., në arsye specifike dhe konkrete – të cilit të bëjnë të besosh se i akuzuari përbën rrezik për interesin publik i cili mund të zvogëlohet vetëm me anë të vazhdimit të paraburgimit.²⁴ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, në bazë të provave të disponueshme, arsyet konkrete të artikulueshme duhet të mbështesin “besimin”²⁵ se ekzistojnë rreziqet e parapara në secilin prej tre paragrafëve të nenit 41(6)(b) të Ligjit, që tregojnë pranimin e mundësisë dhe jo të pashmangshmërisë së një ngjarjeje të ardhshme.²⁶ Me fjalë të tjera, megjithëse dyshimi në vetvete nuk mjafton, nuk kërkohet të qenit plotësisht i sigurt.²⁷

1. Rreziku i arratisjes

15. Në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk do të vlerësojë nëse i akuzuari “do të arratiset në të vërtetë” po të

²³ Neni 19.1.30 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të vitit 2012, Ligji nr.04/L-123 jep këtë përcaktim për termin “artikulueshëm”: “pala e cila paraqet informacionin apo provën duhet të specifikojë në detaje informatën apo provën në të cilën mbështetet”.

²⁴ KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave Miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas Nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar* (“Aktvendimi i DHSGJK-së i datës 26 prill 2017”), 26 prill 2017, para. 113, 115.

²⁵ *Shih* elementet kryesorë të nenit 41(6)(b) të Ligjit.

²⁶ Vendimi i Dytë i Rishikimit, para. 16. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07, IA001/F00005, Dhoma e Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbjajtjen e tij në Paraburgim*, 9 dhjetor 2020, publik, para. 63, 67.

²⁷ KSC-BC-2020-06, F00178, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Kadri Veselit për Lirim të Përkohshëm*, 22 janar 2021, publik, para. 21.

lirohet, por do të përcaktojë, në bazë të parashtrimeve të palëve, nëse (ende) ekziston mundësia e një ndodhie të tillë në të ardhmen.²⁸

16. Në lidhje me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton konstatimin e tij²⁹ se z. Mustafa ka motivin dhe mjetet për t'u arratisur, bazuar në faktorët e mëposhtëm: (i) njohja me akuzat kundër tij dhe dënimin e mundshëm; (ii) dijenia për dënimet e raportuara publikisht të komandantëve të lartë të Zonës Operative të Llapit; (iii) lidhjet me aparatën e shërbimit të zbulimit të Kosovës që i jep qasje në informacion dhe burime; dhe (iv) mundësia për të udhëtuar lirisht në shtete që nuk kërkojnë vizë.³⁰

17. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se ZPS-ja ka përfunduar nxjerrjen e provave fajësuese dhe ka dorëzuar Dosjen Paraprake, listën e dëshmitarëve (përfshirë edhe dëshmitarë identiteti i të cilëve i është bërë i ditur Mbrojtjes), dhe listën e provave materiale,³¹ duke përvijuar plotësisht çfarë synon të paraqesë gjatë gjyqimit. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se kjo gjë e bën të qartë natyrën e rëndë të akuzave dhe e bën më konkrete mundësinë e shpalljes fajtor dhe dhënien e një dënimi me burgim për kohë të gjatë.

18. Mbrojtja nuk ofron informacion që demonstroi rrethana të reja apo të ndryshuara që do të ndikonin në rrezikun e arratisjes, por thjesht përsërit parashtrimet e mëparshme në lidhje me bashkëpunimin e z. Mustafa me ZPS-së dhe mospasjen e interesit për t'u arratisur nga Kosova,³² gjë e cila është shqyrtuar

²⁸ Shih para. 14 më lart.

²⁹ Vendimi i Dytë i Rishikimit, para. 19.

³⁰ Vendimi për Arrestim dhe Transferim, para. 20; Fletarrestimi, para. 5.

³¹ KSC-BC-2020-05, F00085, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Versioneve të Redaktuara Konfidenciale të Dosjes Paraprake, Listës së Dëshmitarëve, dhe Listës së Provave Materiale, 17 shkurt 2021, publik, me Shtojcat 1-3, konfidenciale*; F00088, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Dosjes Paraprake të Korrigjuar, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe ex parte, dhe Shtojcën 2, konfidenciale.*

³² Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 18-20.

tashmë në Vendimin e Dytë mbi Rishikimin e Paraburgimit.³³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se në procesin aktual gjatë kësaj kohe nuk ka pasur informacion apo zhvillim të ri që do të justifikonte konstatimet e mësipërme; përkundrazi, afrimi i datës për finalizimin e fazës së procedurës paraprake dhe për dorëzimin e dosjes së së çështjes Trupit Gjykses, sipas rregullës 98(1) të Rregullores, vazhdojnë të demonstrojnë rrezikun e arratisjes.

19. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se z. Mustafa ende paraqet rrezik për arratisje.

2. Rreziku i pengimit të ecures së procesit të DHS-së

20. Sa i përket rrezikut të pengimit të procesit të DHS-së, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton konstatimin e tij³⁴ se shtrirja e kufizuar kohore dhe gjeografike e kësaj çështjeje gjyqësore do të lehtësonte procesin e identifikimit dhe ndërhyrjes te viktimat dhe dëshmitarët, veçanërisht për një punonjës me përvojë të shërbimit të zbulimit siç është z. Mustafa.³⁵ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se rreziku konkret i shpalljes fajtor dhe rrjedhimisht shqiptimit të dënimit, e shton motivimin e z. Mustafa për ndërhyrje ndaj viktimave dhe dëshmitarëve,³⁶ veçanërisht tani pasi ai është informuar, përmes Dosjes Paraprake dhe materialit përkatës, për dosjen e plotë të çështjes që ZPS-ja synon të paraqesë në gjykim, përfshirë edhe identitetin e disa dëshmitarëve.³⁷

21. Sa i takon këtij rreziku, Mbrojtja nuk ofron informacion që demonstroi rrethana të reja ose të ndryshuara, por thjesht përsërit parashtrimet e mëparshme, përkatësisht se z. Mustafa bashkëpunoi me ZPS-në dhe të akuzuarit nuk mund t'i

³³ Vendimi i Dytë i Rishikimit, para. 20.

³⁴ Vendimi i Dytë i Rishikimit, para. 24.

³⁵ Vendim për Arrestim dhe Transferim, para. 21; Fletarrestimi, para. 5.

³⁶ Vendimi i Dytë i Rishikimit, para. 24.

³⁷ *Shih më lart* para. 17.

atribuohet asnjë incident konkret për pengimin e procesit penal .³⁸ Këto parashtrime, të cilat u rrëzuan në Vendimin e Dytë të Rishikimit,³⁹ nuk i zhvlerësojnë konstatimet se z. Mustafa ka motivin dhe mjetet për të penguar procesin e DHS-së, duke pasur parasysh njohurinë e të akuzuarit për çështjen gjyqësore dhe provat kundër tij. Kjo është sidomos e vërtetë në këtë fazë të procesit, pasi i akuzuari është informuar, përmes Dosjes Paraprake, për çështjen gjyqësore të ZPS-së që do të paraqitet në gjykim, dhe ka marrë përmbledhjet e dëshmimeve të dhëna nga dëshmitarët e ZPS-së, të cilat përfshijnë dëshmitarë identiteti i të cilëve tashmë është i njohur nga Mbrojtja.⁴⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se në procesin aktual gjatë kësaj kohe nuk ka pasur informacion apo zhvillim të ri që do të cenonte konstatimet e mësipërme.

22. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Mustafa të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së duke ndërhyrë te viktimat dhe dëshmitarët.

3. Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera

23. Sa i përket rrezikut të kryerjes së krimeve të tjera, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton konstatimin e tij⁴¹ se z. Mustafa është mburrur publikisht për ekzekutimin e serbëve në një konferencë për shtyp të mbajtur rreth 14 qershorit 1999 në Prishtinë, duke demonstruar kështu rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera ndaj viktimave dhe dëshmitarëve .⁴² Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton gjithashtu konstatimin e tij të bërë më sipër se ekziston rreziku që z. Mustafa të

³⁸ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 32-33.

³⁹ Vendimi i Dytë i Rishikimit, para. 25.

⁴⁰ KSC-BC-2020-05, F00085/A02, Prokurori i Specializuar, Shtojca 2 e *Parashtrimet të Versioneve të Redaktuara Konfidenciale të Dosjes Paraprake, Listës së Dëshmitarëve, dhe Listës së Provave Materiale*, 17 shkurt 2021, konfidenciale, f. 20-24.

⁴¹ Vendimi i Dytë i Rishikimit, para. 29.

⁴² Vendim për Arrestim dhe Transferim, para. 22; Fletarrestimi, para. 5.

pengojë procesin e DHS-së.⁴³ Ndonëse ekzistenca e rrezikut të pengimit të procesit nuk nënkupton automatikisht rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera, në rrethanat e çështjes aktuale faktorët mbi të cilët mbështetet rreziku i parë janë me rëndësi për vlerësimin e këtij të fundit,⁴⁴ veçanërisht duke pasur parasysh kuadrin e kufizuar të akuzave. Duke marrë parasysh sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se në procesin aktual nuk ka pasur ndonjë informacion apo zhvillim të ri që do të cenonte konstatimin se, i përballur me mundësinë e shpalljes fajtor dhe rrjedhimisht shqiptimin e dënimit, z. Mustafa mund të kryejë krime kundër viktimave ose dëshmitarëve të DHS-së që kanë dhënë dëshmi për veprimet e tij të pretenduara.

24. Sa i takon këtij rreziku, Mbrojtja nuk ofron ndonjë informacion që demonstroi rrethana të reja ose të ndryshuara, por thjesht përsërit parashtrimet e mëparshme, përkatësisht se z. Mustafa bashkëpunoi me ZPS-në dhe se nuk ka precedentë penalë, duke shtuar se kjo i mundësoi që të mbante postin publik.⁴⁵ Këto rrethana nuk zhvlerësojnë vlerësimin se, pasi ai është i informuar tashmë për provat fajësuese kundër tij dhe, çka është më e rëndësishme, dosjen e plotë të çështjes së ZPS-së për gjykim, z. Mustafa ka motivin për të kryer krime të tjera kundër viktimave dhe dëshmitarëve të DHS-së që kanë dhënë dëshmitë e tyre për veprimet e tij të pretenduara.

25. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Mustafa të kryejë krime të tjera.

⁴³ *Shih më lart* para. 20-22.

⁴⁴ *Ngjashëm* KSC-BC-2020-06, F00177/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Hashim Thaçit për Lirim të Përkohshëm*, 22 janar 2021, publik, para. 48.

⁴⁵ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 11-15.

4. Përfundim

26. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se në procesin aktual nuk ka pasur ndonjë informacion apo zhvillim të ri që të cenonte konstatimin se ka arsye të artikulueshme për të besuar se të tre rreziqet e parashikuara në nenin 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit vazhdojnë të ekzistojnë.

C. LIRIMI ME KUSHT

27. Sa i takon rrezikut të arratisjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se disa nga Kushtet e Propozuara, konkretisht, zotimi i z. Mustafa për të qëndruar në arrest shtëpiak ose në ndonjë formë tjetër alternative paraburgimi, të ketë të instaluar pajisje teknike monitoruese për të siguruar që ai të mos largohet nga shtëpia, të dorëzojë pasaportën e tij tek autoritetet kompetente, të kërkojë leje për çdo udhëtim të lidhur me punën, të paraqitet para një punonjësi të sigurisë së ZPS-së, dhe të paraqitet para DHS-së nëse urdhërohet për ta bërë këtë, të zbatuara në mënyrën e duhur mund ta zvogëlonin këtë rrezik. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmon konstatimet e mëparshme të tij se rreziku i arratisjes mund të menaxhohet, nëse z. Mustafa do të lirohet me kushte të përshtatshme.⁴⁶

28. Sa i përket rrezikut të pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së ose të kryerjes së krimeve të tjera, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se, duke pasur parasysh pozitën e z. Mustafa brenda aparatit të sigurisë dhe të zbulimit të Kosovës, asnjë nga Kushtet e Propozuara, duke përfshirë të gjitha kufizimet shtesë të vendosura nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, nuk mund të kufizojnë aftësitë e z. Mustafa për të pasur qasje në informacion dhe mjete që do të lehtësonin çdo përpjekje për penguar procesin e DHS-së, përmes ndërhyrjes te viktimat dhe

⁴⁶ Vendimi i Dytë i Rishikimit, para. 35.

dëshmitarët, ose për kryerjen e krimeve të tjera. Kjo vlen pavarësisht nëse z. Mustafa e vazhdon punësimin e tij aktual apo jo. Në lidhje me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se, në kundërshtim me pretendimet e Mbrojtjes, frika e humbjes së vendit të punës nuk mund të konsiderohet si faktor bindës në vlerësimin aktual, pasi është pasojë e drejtpërdrejtë (e mundshme) e procesit penal që përfshin mbajtjen në paraburgim të të akuzuarit sipas Ligjit.

29. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se asnjë nga Kushtet e Propozuara nuk mund të kufizojë apo të monitorojë komunikimet private të z. Mustafa, përmes të cilave ai mund të kërkojë ose marrë pa rënë në sy informata dhe mjete që i mundësojnë ndërhyrjen te viktimat dhe dëshmitarët e DHS-së, ose kryerjen e krimeve të tjera në këtë drejtim. Kufizimi i lëvizjeve të z. Mustafa po ashtu nuk do ta zvogëlonte këtë rrezik. Gjithashtu, ndalimi i z. Mustafa që të takojë dëshmitarët, personat që kanë lidhje me këtë çështje gjyqësore apo, qoftë edhe çdo person në Kosovë, as nuk mund të realizohet, e as të monitorohet, pavarësisht nëse një ndalim i tillë ka të bëjë me kontakte personale apo është komunikim përmes mjeteve elektronike. Komunikimet e z. Mustafa mund të kufizohen dhe monitorohen me efektivitet vetëm me anë të kornizës së monitorimit të komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të DHS-së, duke zvogëluar kështu rreziqet që ai të pengojë procesin e DHS-së, apo të kryejë krime të tjera.

30. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Kushtet e Propozuara, duke përfshirë kufizimet shtesë të vendosura nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, nuk do të zvogëlonin mjaftueshëm rreziqet e pengimit të procesit të DHS-së apo të kryerjes së krimeve të tjera dhe, për këtë arsye, z. Mustafa duhet të vazhdohet të mbahet në paraburgim.

V. VENDIM

31. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Mustafa;
- b. **URDHËRON** Mbrojtjen të dorëzojë parashtrime për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit deri të martën, 11 maj 2021; dhe
- c. **URDHËRON** ZPS-në që t'u përgjigjet parashtrimeve të Mbrojtjes, nëse do të ketë, deri të hënën, 17 maj 2021.

_____/nënshkrim/_____

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E enjte, 25 mars 2021
Hagë, Holandë